



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 683/3 Prot.

Tiranë, më 14 / 8 /2018

V E N D I M

Nr. 162, datë 14 / 08 /2018

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, bazuar në ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mori në shqyrtim ankesën nr. 65, datë 16.05.2018 të shtetasit P.V, me pretendimin e diskriminimit nga ana Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë (në vijim QSUT) në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike¹” dhe “çdo shkak tjetër²”. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I :

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

P.V në ankesën e tij pretendon se që pas zgjedhjeve të vitit 2013, trajtohet në mënyrë diskriminuese nga ana e drejtuesve të QSUT-së, për shkak të denoncimeve të bëra në media, lidhur me problematikat që paraqiten në menaxhimin dhe furnizimin me medikamente të pavioneve të ndryshme të Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”. Sipas ankuesit, trajtimi në mënyrë të disfavorshme dhe diskriminuese ka vijuar me inicimin e procedurave të largimit nga puna nga ana e Drejtuesve të QSUT-së, për një ngjarje të ndodhur në ambjentet e Urgjencës së Sëmundjeve të Brendshme, më datë 17.08.2017. Në këtë datë, pranë ambjenteve të Urgjencës së Sëmundjeve të Brendshme, është paraqitur një person i dhunshëm me probleme mendore, i cili me shumë vështirësi u arrit të neutralizohej nga punonjësit e Policisë së Shtetit. Gjatë kësaj kohe, në ambjentet e Urgjencës së Sëmundjeve të Brendshme ka qënë prezent dhe ankuesi, P.V, i cili, ka patur detyrën e mjekut në Triazh. Duke qënë se ishte e pamundur të ndërhynte, pas neutralizimit nga ana e punonjësve të Policisë së Shtetit, ankuesi i ka dhënë ndihmë personit, duke kryer injektimin e medikamentit për qetësimin e tij, si dhe ka njoftuar ambulancën, për ta

¹ P.V ka qënë anëtar (LSI) i Këshillit Bashkiak Tiranë për periudhën 2007-2011 dhe kandidat në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 18.06.2017 për subjektin politik: Lëvizja Socialiste për Integrim.

² Subjekti ankues pretendon se është viktimizuar për shkak të denoncimeve të bëra në median e shkruar dhe vizive kundër politikave shëndetësore të qeverisë.

³ Në vijim do t'i referohemi me shkurtesën: KMD.

dërguar personin në Shërbimin e Psikiatrisë, për verifikim të gjendjes së tij mendore, e trajtim të mëtejshëm nëse do të ishte e nevojshme.

Referuar ngjarjes së sipërcituar, nga ana e QSUT-së kanë nisur procedurat për largimin nga puna të P.V, me arsyetimin se ankuesi ka vepruar në shkelje të rregullave të etikës së profesionit të mjekut duke mos kryer asnjë shërbim ndaj një pacienti me problematikë psikomotore.

Përsa me lart dhe mbështetur në kopjen e Kërkesë-Padisë së depozituar pranë KMD-së më datë 07.12.2017, ankuesi ka paditur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, Institucionin e QSUT-së, me objekt: “Dëmshpërblimin për shkak të zgjidhjes së padrejtë të kontratës së punës të pajustificuar...” si dhe ka pretenduar trajtimin e disfavorshëm dhe diskriminues në formën e viktimizimit, duke e larguar nga puna.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi më Vendimin nr. 137, datë 14.12.2017 ka vendosur: “Pushimin e shqyrtimit të ankesës nr.121, datë 05.09.2017, për shkak të çështja është duke u gjykuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë”.

Me shkresën Vërtetim datë 22.05.2018 të lëshuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, Tiranë subjekti ankues ka njoftuar Komisionerin mbi Vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë në të cilën është vendosur: “-Deklarimi i moskompetencës lëndore të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë për gjykimin e çështjes me nr.rregj.them.4799 (5553), datë 18.09.2017 dhe –Kalimin e padisë dhe të akteve pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqsor Tiranë”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe rikthimin në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, P.V, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankesë, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

A. Me shkresën Nr. 683/1, datë 30.05.2018 është bërë njoftimi i subjektit QSUT, në lidhje me ankesën për diskriminim të paraqitur nga P.V.

Palët e interesuara kanë marrë dijëni për shkresën me anë të: Lajmërim Marrje poste: RR295667075AA, RR295667092AA, datë 31.05.2018 dhe nuk kanë kthyer përgjigje.

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në kuadër të shqyrtimit të ankesës nr.121, datë 05.09.2017 të shtetasit P.V kundër QSUT-s është vënë në dijëni të fakteve si më poshtë:

B. QSUT, me anë të shkresës nr. 3467/12 prot., datë 12.09.2017 ka sqaruar se: *“Punonjësit e Policisë së Shtetit M.D, D.H dhe R.B, kanë depozituar në protokollin e QSUT “Nënë Tereza”, në datën 17.08.2017, shkresën e protokolluar me nr. 3450 prot., duke referuar pranë Drejtorit të Përgjithshëm të QSUT një ngjarje të ndodhur në ambjentet e Urgjencës së Sëmundjeve të Brendshme, në të cilën është paraqitur një person i dhunshëm të cilin as prindërit e tij nuk arrinin ta mbanin në kontroll. Punonjësit e Policisë së Shtetit me ndërhyrjen e tyre me iniciativë e në bashkëveprim me punonjësit e Policisë Private, që kanë ruajtje QSUT “Nënë Tereza”, bënë të mundur neutralizimin e personit agresiv. Gjatë gjithë kohës prezent në këtë ngjarje, në ambjentet e Urgjencës së Sëmundjeve të Brendshme ka qënë dhe një nga mjekët e këtij shërbimi, P.V, i cili, siç referohet në ankesë dhe siç konstatohet qartë dhe nga pamjet filmike, nuk ka ndërmarrë asnjë masë, madje përkundrazi, me indiferentizëm ka filmuar ngjarjen me celular. Në këtë moment, në ambjentet e Urgjencës mbërriti fare rastësisht, titullari i institucionit, e mjeku P.V vetëm pasi vuri re prezencën e tij, reagoi duke i dhënë ndihmë personit, e duke kryer injektimin e Diazepamit, si dhe njoftoi ambulancën, për ta dërguar personin në Shërbimin e Psikiatrisë, për verifikim të gjendjes së tij mendore, e trajtim të mëtejshëm nëse do të ishte e nevojshme. Përsa më sipër, kemi vlerësuar se mjeku P.V me veprimet e mosveprimet e tij ka cënuar rëndë e shpërfillur detyrimet nga parashikimet e dispozitave në nenet 4, 5, 9, 24 dhe 67 të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore. Mbi rrethanat e ngjarjes, e në*

referimin e bërë nga policia e Shtetit me shkresën e sipërcituar, për kompetencë e vendimmarrje, me shkresën nr. 3450/1 prot., datë 29.08.2017, i jemi adresuar Urdhrit të Mjekut të Shqipërisë, i cili në përgjigjen e tij nr. 103/1 prot., datë 08.09.2017 protokolluar me nr. 3540/2 prot., datë 08.09.2017, ndër të tjera informon se ka filluar praktikën e shqyrtimit të ankesës. Njëkohësisht Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe përfaqësues të Drejtorisë së Përgjithshme, sipas njoftimit të bërë rregullisht me shkresën nr. 3467/3 prot., datë 24.08.2017, ka organizuar takimin me P.V, për të dëgjuar shpjegimet e tij në lidhje me ngjarjen dhe ankesën e referuar. Në takimin e caktuar në datën 07.09.2017, është mbajtur dhe procesverbali përkatës, i cili është ende në proces vlerësimi”.

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e pabarabartë ose të pafavorshëm.

Ankuesi P.V që nga viti 1989 ka qenë në marrëdhënie punësimi pranë Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza” në pozicionin si mjek.

Me shkresën nr.3467, datë 19.08.2017 subjekti ankues është njoftuar nga QSUT për zhvillimin e një takimi në lidhje me situatën e ndodhur në Urgjencën e Sëmundjeve të Brendëshme në datë 17.08.2017. Me shkresën nr.3467/3, datë 24.08.2017, P.V është njoftuar për shtyrjen e takimit për një datë tjetër. Në datë 07.09.2017 është zhvilluar takimi ndërmjet subjekteve, në të cilën palët kanë parashtruar argumentet e tyre.

Me shkresën nr. 3450/1, datë 29.08.2017 QSUT i është adresuar Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë për kompetencë e vendimmarrje, i cili me përgjigjen nr.103/1, datë 08.09.2017 ka informuar QSUT-n se ka filluar praktikën e shqyrtimit të ankesës.

Me Vendimit Nr. 560, datë 13.09.2017 të QSUT-s, P.V është vënë në dijeni për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës në datë 29.12.2017, për moskryerje të detyrave funksionale, sipas së cilës mjeku i shërbimit mjekësor në QSUT: *“Përgjigjet për realizimin e plotë dhe në kohë të protokolleve të mjekimit dhe të procedurave të tjera të caktuara për të sëmurët e tij” si dhe në shkëlqje të nenit 2/2 të Kodit Etik: “Të gjithë pacientët duhet të trajtohen në mënyrë të barabartë, me standart të njëjtë duke parandaluar çdo qëndrim diskriminues. Duhet të shmangen sjellje të paqarta dhe të dyshimta”.*

Ligji nr. 123/2014 “Për Urdhrin e Mjekëve në Republikën e Shqipërisë” ka për qëllim përcaktimin e rregullave të organizimit dhe të veprimtarisë së Urdhrit të Mjekëve dhe marrëdhëniet juridike të profesionistëve mjekësorë, ligj i cili zbatohet për të gjithë mjekët që ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë në sistemin publik apo privat. Në nenin 4/1 të këtij ligji përshkruhet misioni i Urdhrit të Mjekëve, në të cilën përcaktohet se: *“Misioni i Urdhrit të Mjekëve është ruajtja e standardeve të larta në formimin dhe ushtrimin e profesioneve në*

fushën e mjekësisë dhe mbrojtja e pacientëve dhe publikut nga kequshtrimi i profesionit të mjekut”.

Në nenin 16/2 të ligjit të mësipërm përcaktohet se: *“Komisioni shqyrton ankesat e bëra nga çdo person apo institucion në organet e Urdhrit, të cilat lidhen me ushtrimin e profesionit dhe përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore”.*

Në nenin 1 të Rregullores për Gjykimin Disiplinor Profesional të miratuar me Vendimin nr.1, datë 08.04.2016 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë, i ndryshuar, përcaktohet se: *“1. Gjykimi Disiplinor Profesional dhe Rregullorja e Gjykimit Disiplinor Profesional janë bazuar në ligjin nr.123/2014 “Për Urdhrin e mjekëve në Republikën e Shqipërisë”, në Kodin e Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe në Statutin e U.M.Sh-s. 2.Mbështetur në këto akte normative, Urdhri i Mjekëve të Shqipërisë ndërmerr veprime dhe bën gjykimin disiplinor profesional të anëtarit të vet në rastet kur: b. Ka një akuzë për mjekim të pakujdesshëm apo sjellje profesionale të padenjë. e. Veprimet dhe sjellja e tij përbëjnë shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore dhe të legjislacionit në fuqi”.*

Në vlerësim të legjislacionit të sipërcituar, Komisioneri vlerëson se organi që ka kompetencën kryesore për vlerësimin profesional dhe etik të mjekëve janë Komisionet Disiplinore të Urdhrit të Mjekëve të Republikës së Shqipërisë.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni Disiplinor Profesional i Këshillit Rajonal Tiranë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga QSUT kundrejt anëtarit të UMSH-së, P.V, për shkelje të Kodit të Etikës dhe Deontologjisë Mjekësore, gjatë ngjarjes së datës 17.08.2017 dhe pas shqyrtimit të dokumenteve të dorëzuara nga palët, me Vendimin nr. 09, datë 09.10.2017, ka vendosur shpalljen të pafajshëm të P.V.

Vendimi i mësipërm është marrë në shqyrtim dhe nga Komisioni i Gjykimit Disiplinor Profesional i Shkallës së Dytë (Apeli), i cili me Vendimin nr. 03, datë 17.11.2017 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit të mësipërm.

Nga parashtrimi i fakteve dhe shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga palët, Komisioneri vlerëson se, duke patur në vëmendje profilin publik dhe veprimtarinë politike të P.V drejtuesit e QSUT janë shpejtuar në marrjen e vendimit për shpëputjen e marrëdhënieve të punës me P.V, pasi në zbatim të kompetencave ligjore mund të kishin pritur vendimin përfundimtar të Komisioneve Disiplinore të Urdhrit të Mjekëve të Republikës së Shqipërisë dhe pastaj bazuar në gjetjet dhe konstatimet e Komisioneve Disiplinore mund të kishin ndërmarrë veprime në drejtim të mjekut P.V.

Komisioneri ka bindjen se fakti që QSUT nuk ka marrë për bazë dhe mendimet profesionale të mjekëve⁴ të repartit ku ka ndodhur ngjarja, tregon veprimet tendencize dhe të shpejta të QSUT për të zgjidhur marrëdhëniet e punës me P.V.

⁴Shkresa datë 18.08.2017 të zv/Shefit të Shërbimit të Urgjencës së Sëmundjeve të Brendëshme në të cilën shkruhet se: “Kolektivi mendon se është bërë gjithshka konform rregullave”.

Komisioneri vlerëson se nga ana e QSUT-s nuk është vënë në dispozicion të Komisionerit asnjë provë për të faktuar se ndërprerja e marrëdhënieve të punës me P.V është bërë për shkak të moskryerjes së detyrave funksionale dhe për shkelje të Kodit të Etikës, pasi QSUT-ja dështoi për të dërguar pranë Komisionerit, kopje të protokollit të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë, lidhur me trajtimin e pacientëve që paraqesin problematika psikomotore, kopje të rregullores, protokollit apo dispozitave ligjore mbi të cilën mbështeten detyrat dhe përgjegjësitë e mjekut në Triazh dhe informacionin mbi rezultatet e hetimit për të gjetur përgjegjësitë për punonjësit e tjerë gjatë ngjarjes së datës 17.09.2017⁵.

Komisioneri vlerëson se vendimmarrja e drejtuesve të QSUT ka qenë e paarsyeshme dhe jo proporcionale pasi është bazuar më shumë në relacionin informues të punonjësve të Policisë së Shtetit se sa në opinionin dhe vlerësimet profesionale të mjekëve të repartit të urgjencës dhe Komisionit Disiplinor të Urdhrit të Mjekëve të Republikës së Shqipërisë.

Veprimet tendencioze të QSUT në drejtim të mjekut P.V përforcohen për më tepër dhe nga qëndrimet publike⁶ të mbajtura nga ana e P.V në lidhje kundërshtimet e politikave shëndetësore dhe mungesës së ilaçeve në spitale gjatë periudhës pas vitit 2014 dhe disa masave disiplinore të marra nga ana e QSUT në drejtim të P.V të cilat janë kundërshtuar në gjykatë dhe i kanë dhënë të drejtë pretendimeve të P.V.

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 30.11.2017, përfaqësuesja e QSUT konfirmoi faktin që QSUT është në proces gjyqësor me P.V për një masë disiplinore të dhënë në vitin 2017⁷.

Për sa më lart, Komisioneri duke mos gjetur shkak të ligjshëm për largimin e ankuesit nga puna konstaton se P.V është trajtuar në mënyrë të pafavorshme dhe se masa e marrë për largimin e tij nga puna është i qëllimshëm, i pajustificuar dhe i pa argumentuar ligjërisht.

B. Shkaku i mbrojtur.

Për të vërtetuar se ndaj subjektit ankues ka një sjellje diskriminuese nga ana e QSUT-s, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁸ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankuesit.

Pretendimi i P.V se shkak për diskriminim ndaj tij janë bërë bindjet e tij politike dhe qëndrimet publike të mbajtura kundër politikave shëndetësore të qeverisë, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit.

⁵ Referuar procesverbalit të seancës dëgjimore datë 30.11.2017.

⁶ Intervistë datë 20.01.2014 për TV Klan, emision datë 25.04.2014 në RTSH, intervistë datë 11.01.2016 për News 24, emision datë 08.02.2016 në News 24. Gazeta Telegraf datë 24.09.2014, Gazeta Shqiptare datë 27.10.2015, Gazeta Shëndeti datë 30.03.2017, Gazeta Telegraf datë 23.01.2017.

⁷ Referuar Procesverbalit të seancës dëgjimore datë 30.11.2017.

⁸ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Nga shqyrtimi i dokumenteve nga Komisioneri, rezulton se P.V ka qenë anëtar i Këshillit Bashkiak Tiranë për subjektin politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” e vërtetuar me anë të Vendimit nr.14, datë 23.03.2007 “Për miratimin e mandatit të Këshilltarëve” të Këshillit Bashkiak Tiranë si dhe ka qenë kandidat për deputet i subjektit politik “Lëvizja Socialiste për Integrim” në zgjedhjet për Kuvendin e Shqipërisë të vitit 2017.

C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur.

Komisioneri vlerëson se të gjitha pasojat negative deri në zgjidhjen e marrëdhënieve të punës mes subjektit ankues dhe punëdhënësin QSUT, kanë ardhur pas qëndrimeve publike të mbajtura nga P.V dhe pas kandidimit të tij në zgjedhjet e vitit 2017 për subjektin politik LSI.

Komisioneri ka bindjen se fakti që QSUT nuk ka pritur vendimmarrjen profesionale të Komisioneve Disiplinore të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë por ka dhënë vendimin për largimin e P.V nga puna, tregon tendencën e QSUT-s për të ndërprerë marrëdhëniet e punës me subjektin ankues pa marrë parasysh mendimin profesional të Urdhrit të Mjekëve të Shqipërisë dhe të stafit mjekësor të Shërbimit të Urgjencës së Sëmundjeve të Brendëshme të cilët me shkresën datë 19.09.2017 kanë kërkuar rishikimin e vendimit të përjashtimit nga puna të P.V.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 12, pika 1, germa c), parashikon se: “Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: ...c) trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimin, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.

Në këtë kontekst, referuar nenit 7/1⁹, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se P.V, është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e QSUT-s, trajtim i cili ka lidhje të me bindjen politike dhe qëndrimet publike të ankuesit.

Diskriminimi përkufizohet nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3, pika 1, si: “Çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

⁹ Në nenin 7, pika 1, të ligjit nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”.

Në nenin 3/1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.*

Në përfundim për sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson se P.V, është ekspozuar ndaj një trajtimi të pafavorshëm dhe diskriminues, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë trajtim i cili ka lidhje me bindjen politike të ankuesit.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet 1, 2, 3/1, 7/1, 12, 13 nenin 32, pika 1/a), si dhe nenin 33, pika 10 të Ligjit Nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të shtetasit P.V, nga ana e Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, për shkak të bindjes politike.
2. Në referim të pikës 1, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, si subjekt që ka konsumuar sjelljen diskriminuese, të bëjnë rikthimin e P.V në vendin e mëparshëm të punës.
3. Bazuar në nenin 33 pika 11, të ligjit “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Qendra Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, Tiranë, detyrohen që brenda 30 (tridhjetë) ditëve të njoftojnë Komisionerin, lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11 e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONERI

Robert GAJDA

Hartoi: A. Xhindi
Pranoi: V. Bushati
Datë: 13.08.2018